



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 300 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023

VENDIM

Nr. 11, datë 15/03/2023

MBI

**“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË DOKUMENTACIONIT PËR REDUKTIM NGA
TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE (MASTER) PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 79, dt.01.11.2022, “Fillimin e pranimeve të aplikimeve, nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023, në Universitetin e Arteve, në shkresën nr. 4 prot., datë 20.01.2023 të FAB dhe nr. 70 prot., datë 20.01.2023 të UART, si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues në përmbushje të kriterëve të përcaktuara për përfitim dhe sipas akteve të dala për këtë qëllim, Bordi i Administrimit, pas shqyrtimit dhe diskutimit,

VENDOSI:

1. Miratimin në fazë të dytë për reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve Master pranë Ftë Arteve të Bukura, për vitin akademik 2022-2023.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ

(Kryetar)

Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir Llakaj

(Anëtar)

